



Shkolla e Spresiano
Rruga U. Foscolo, 4
31027 Spresiano (TV)
Tel. 0422.725223

e-mail: segreteria@icspresiano.it

SHKOLLA JONË

Informacione për prindërit e sapo ardhur

*Si funksionon shkolla fillore dhe tetëvjeçare në Itali dhe
veçanërisht në Spresiano dhe Arcade.*



MIRËSEERDHËT NË VENDIN TONË DHE NË SHKOLLAT TONA

Para së gjithash ju themi “Mirëseerdhët”, në Itali dhe në shkollat italiane, juve dhe fëmijëve tuaj.


Kjo broshurë na jep mundësinë që t’ju përshëndesim me mikpritje dhe t’ju ndihmojmë të kuptoni si funksionon shkolla italiane.

Mund të regjistroni menjëherë fëmijën tuaj edhe pse viti shkollor ka filluar; të gjithë fëmijët kanë të drejtë të frekuentojnë shkollën edhe nëse nuk janë në rregull në lidhje me ligjin për lejen e qëndrimit (*permesso di soggiorno*) (*ONU, Konventa Ndërkombtare mbi të drejtat e Fëmijëve Art. 28*).





SA VITE ZGJAT SHKOLLA NË ITALI?



EMËRTIMI I SHKOLLËS	MOSHA
Çerdhe (Asilo nido)	Nga 0 deri 3 vjeç
Kopësht (S. dell'infanzia)	Nga 3 deri 6 vjeç
Shkolla Fillore (S. Primaria)	Nga 6 deri 11 vjeç
Shkolla tetëvjeçare (S. Secondaria di I grado)	Nga 11 deri 14 vjeç
Shkolla e Mesme (S. Secondaria di II grado)	Mbi 14 vjeç

Arsimimi i detyrueshëm zgjat 10 vite:

- 5 vite shkollë fillore
- 3 vite shkollë tetëvjeçare
- 2 vite shkollë të mesme

SHKOLLAT TONA

Shkollat e Spresiano-s përfshijnë 6 shkolla:

4 fillore dhe 2 tetëvjeçare .

VENDI	SHKOLLA	ADRESA	TELEFON
ARCADE	Fillore	Via Corazzin 17 31030 Arcade (Treviso)	0422 774064
LOVADINA	Fillore	Via Irti Isaia 47 31020 Lovadina di Spresiano (Treviso)	0422 725672
SPRESIANO	Fillore	Via Montello 32 31027 Spresiano (Treviso)	0422 725256
VISNADELLO	Fillore	Via Monsignor Condotta 1 31050 Visnadello di Spresiano (Treviso)	0422 92114
ARCADE	Tetëvjeçare	Via Marangona, 32 31030 Arcade (Treviso)	422 874056
SPRESIANO	Tetëvjeçare	Via Ugo Foscolo 4 31027 Spresiano (Treviso)	422 725223



Në shkollën fillore librat janë falas: familja duhet të shkoj në Zyrën për shkollën tek Bashkia dhe të marrë kuponin për librat. Ndërsa familjet duhet të blejnë materiale shkolle si, fletore, lapsa, stilolapsa...

RREGJISTRIMI NË SHKOLLË

Fëmijët që mbushin 6 vjeç brenda 31 dhjetorit duhet të rregjistrohen në klasën e parë fillore dhe fillojnë shkollën në shtator edhe pse nuk kanë mbushur ende 6 vjeç. Familjet kanë mundësinë të rregjistrojnë fëmijët në shkollë edhe nëse janë 5 vjeç e gjysë me kusht që fëmija të mbush 6 vjeç brenda 30 prillit të vitit tjetër. Ju këshillojmë në këtë rast të vlersoni mirë pjekurinë e fëmijës me qëllim që të eci i qetë dhe me sukses në rrugën e dijes. Prindërit duhet të kontaktojnë sekretarinë e shkollës dhe të informohen në cilat ditë dhe në ç'orë mund të rregjistrojnë fëmijët. Rregjistrimi bëhet on-line për secilën gradë shkollore. Gjithsesi mund të caktoni një takim me sekretarinë nëse ju nevojitet ndihmë për kryerjen e rregjistrimit.

DOKUMENTAT E NEVOJSHËM

- Çertifikata e lindjes (Nëse nuk e keni çertifikatën sillni pasaportën ose lejen e qëndrimit [permesso di soggiorno]).
- Çertifikatën e vaksinave.
- Dokumenta në lidhje me shkollën që fëmija mund të ketë frekuentuar diku tjetër.
- 1 Fotografi
- Kodin fiskal të fëmijës
- Dokumentat e prindërve

**SEGRETERIA
SCOLASTICA**

Nëse nuk keni dokumentat e sipërpërmendur mund të vetëvërtetoni çka duhet duke mbajtur mbi vete përgjegjësinë si prind.

Sekreteria e shkollës tonë gjendet në rrugën Ugo Foscolo, 4

Tel, 0422 72 52 23



ÇFARË ZGJIDHNI NË MOMENTIN QË BËNI RREGJISTRIMIN ?

Kur bëni rregjistrimin përpiloni modularët për :

1. të zgjedhur llojin e shkollës.
2. të zgjedhur lëndën e fesë apo një tjetër alternativë.

1. ZGJEDHJA E LLOJIT TË SHKOLLËS

Në shkollën fillore mund të zgjidhni që fëmijët tuaj të qëndrojnë në shkollë:

- 40 orë në javë (nga ora 8.00 deri në 16.00 nga e Hëna deri të Premten, vetëm në Lovadina)
- 29 orë në javë (në Spresiano, Visnadello, Arcade)

Në shkollën tetëvjeçare qëndrimi në shkollë është prej 30 orësh në javë si në Spresiano ashtu dhe në Arcade.

Ditët që fëmijët qëndrojnë në shkollë edhe mbasdite mund të hanë në mensën e shkollës. Mbasi mbaron dita e shkollës fëmijët që frekuentojnë shkollën fillore mund të dalin nga shkolla vetëm nëse kanë ardhur prindërit ti marrin apo një tjetër i rritur, në moshë madhore, i autorizuar nga prindërit e fëmijës.



2 LËNDA E FESË KATOLIKE APO ZGJEDHJA ALTERNATIVE

Në shkollën fillore fëmijët bëjnë dy orë lëndë Feje
ndërsa në shkollën tetëvjeçare një orë.

**Në momentin e regjistrimit prindi duhet të
deklarojë nëse zgjedh :**

☐ Avvalersi

Non avvalersi di tale

insegnamento

(dua të bëj lëndën e fesë)
lëndën e fesë)

(nuk dëshiroj të bëj

**Nëse prindërit vendosin që fëmija mos frekuentojë
lëndën e fesë katolike duhet të zgjedhin njërën nga
tre mundësitë e mëposhtme:**

- Aktivitete formuese në grup;
- Aktivitete studimi individual me mbështetjen e një mësuesi;
- dalje një orë para apo një orë më pas nga shkolla, në rastet kur ora e fesë është orën e parë apo orën e fundit të mësimi.

NËSE PRINDËRIT FILLOJNË HERËT APO E MBAROJNË VONË PUNËN

Për ti dhënë zgjidhje këtij problemi në disa nga shkollat fillore është i pranishëm një shërbim mbikqyrje para dhe pas shkolle me orare të ndryshme në bazë të shkollës që fëmija frekuenton. Nëse keni nevojë të rregjistroheni në këtë shërbim duhet të përpiloni një modular të cilit duhet ti bashkangjitni një deklaratë, ku janë të shkruar edhe oraret e punës, nga ana e punëdhënësit për të dy prindërit

Në Spresiano (fillore) dhe në Visnadello është i pranishëm një shërbim mbas shkolle, me pagesë, për ata fëmijë që në ato ditë nuk kanë shkollë mbasdite.



MENSA SHKOLLËS

Në të gjitha shkollat fillore ka mensë dhe është e pranishme edhe në ditët që fëmijët qëndrojnë në shkollë edhe mbasdite. Mensa është me pagesë dhe administrohet nga Bashkia.

Për të aktivizuar shërbimin e mensës duhet ti drejtoheni zyrës së shkollës, që gjendet tek Biblioteka e bashkisë, në Spresiano dhe Bashkisë së Arcade.

Nëse për arsye fetare apo shëndeti fëmija juaj nuk mund të ha disa nga ushqimet, mund të kërkonti një variacion të menusë nëpërmjet një deklarimi që duhet të bëni në momentin e regjistrimit.

Nëse për arsye familjare fëmija juaj duhet të kthehet në shtëpi për të ngrënë duhet të përpiloni një modular ku autorizohet ngrënia e drekës në shtëpi.



KALENDARI SHKOLLOR

Shkolla zgjat 9 muaj. Fillon në mes të shtatorit dhe mbaron në mes të qershorit. Pushimet ndahen në: dy javë për Krishtlindje (zakonisht nga 23 dhjetori deri më 6 janar); një javë për Pashkë (në mars ose prill).

Festa të tjera janë: 1° nëndor, 8 dhjetor, 25 prill, 1° maj, 2 qershor.

Kalendari shkollor jepet gjithmonë në fillim të vitit dhe aty mund të shikoni nëse ka edhe ditë të tjera pushimi. Nëse do ketë ndryshime të tjera në lidhje me pushimet do jeni gjithmonë të informuar nëpërmjet lajmërimeve në **ditar** ose në **regjistrin elektronik**.

Është e rëndësishme që të kontrolloni gjithmonë ditarin!



MUNGESA NGA SHKOLLA

Sa herë që fëmija juaj nuk shkon në shkollë duhet të shkruani në ditar arsyen e mungesës dhe të firmosni; nesë mungon për më shumë se 6 ditë për tu kthyer në shkollë ka nevojë për një çertifikatë mjeksore. Edhe në ato raste kur vjen me vonesë në shkollë apo duhet të dali më herët nga shkolla duhet të paraqesi një justifikim me shkrim nga ana e prindit.

SHËTITJET DIDAKTIKE DHE ESKURSIONET ME SHKOLLËN



Gjatë vitit shkolla organizon shëtitje apo eskursione në qytet dhe në rrethinat e tij. (p.sh. vizita në bibliotekë, muzeume, parqe etj.).

Zakonisht një herë në vit shkohet eskursion me klasën në një tjetër qytet ose në një vend që përbën interes kulturor.

Familja lajmërohet gjithmonë nga shkolla në lidhje me eskursionet dhe prindërve u kërkohet të firmosin një autorizim për pjesëmarrjen e fëmijës.

Shpenzimet e eskursioneve janë shpesh në ngarkim të familjes .

ÇFARË MËSOJNË FËMIJËT TUAJ NË SHKOLLË

(lëndët mësimore)

janë:

- Italiano(lënda e gjuhës)
- Anglisht (në tetëvjeçare edhe frëngjisht)
- Histori
- Gjeografi
- Matematikë
- Shkenca
- Muzikë
- Art dhe imazh
- Edukatë fizike
- Teknologji



Përveç këtyre lëndëve në mënyrë të tërthortë mësohen edhe Edukata Qytetare e Kushtetuta dhe për ata që e kanë zgjedhur lënda e fesë, ose alternativa për ata që nuk kanë zgjedhur fenë.

Në shkollë organizohen edhe aktivitete të tjera me qëllim formues dhe edukues si p.sh. projekti për edukatën rrugore, kultivimi i kopshtit bimor, teatri etj... Këto aktivitete i paraqiten familjeve në fillim të vitit shkollor.

SI VLERISOHEN REZULTATET SHKOLLORE

Çdo vit shkollor është i ndarë në dy pjesë (2 katërmujor : shtator-janar dhe shkurt-qershor). Në janar dhe në qershor mësuesit vlerësojnë rezultatet shkollore të nxënësit dhe pregatisin një skedë që i dorëzohet familjes nëpërmjet regjistrit elektronik. Vlerësimet bëhen me notat nga 1 deri në 10. Kalojnë në klasën e ardhshme nxënësit që kanë të paktën shumicën e notave nga 6 deri në 10. Sjellja vlersohet pa nota vetëm me shkrim



TAKIMI ME PRINDËR

Mësuesit dhe prindërit takohen periodikisht për të folur :

- për programin shkollor;
- për nxënësit dhe për përparimet
- që kanë bërë;
- për vështirësitë që nxënësit hasin dhe për mënyrat e kapërcimit të tyre.



Këto takime janë shumë të rëndësishme sepse edukata e nxënësve dhe përfshirja pozitive e tyre në shkollë varen shumë nga bashkëpunimi ndërmjet shkollës dhe familjes

TAKIMET:

BASHKËBISEDIMET – Mësuesi ju komunikon ditën në të cilën dëshiron t'ju takoj për të folur për fëmijën tuaj. Edhe prindërit nëpërmjet ditarit të fëmijës mund të kërkojnë një bashkëbisedim me mësuesit.

KUVEND – Në fillim të vitit shkollor, shkolla organizon një kuvend klase me prindërit. Në këtë rast mësuesit i paraqesin prindërve aktivitetet shkollore. Gjatë vitit mund të bëhen edhe të tjera mbledhje.

REGJISTRI ELEKTRONIK

Regjistri elektronik shkollor është një regjistër **on line**, që shkolla e Spresiano-s e përdor për të thjeshtuar komunikimet dhe mardhëniet administrative me familjet. Prindërit mund të ndjekin direkt, vazhdimsinë shkollore të fëmijëve të tyre, tematikat e mësimëve, mungesat, detyrat për shtëpi dhe të shohin dëftesën e notave.

Kordinatat për tu futur në këtë regjistër jua kalon shkolla në fillim të vitit të parë të shkollës fillore. Regjistri mund te konsultohet nga **kompjuteri** ose nga **smartphone(celulari)** me **Aplikacionin** për Apple o Android.



<https://nuvola.madisoft.it/login>



Documenti

Nome	
PAGELLINO RISULTANZE SCRUTINIO FINALE	Pagellino scrutinio finale (II perio
SCHEDA DI VALUTAZIONE A.S. 14_15	Scheda di Valutazione a.s. 14_15

SPORTEL DËGJIMI DHE NDËRMJETËSIMI GJUHËSOR

Në shkollën e Spresiano-s është i pranishëm një sportel për ndërmjetësimin gjuhësor i cili ka për qëllim të lehtësoj komunikimin dhe shkëmbimin ndërmjet prindërve të fëmijëve të huaj dhe mësuesëve. Në takimin a parë të pritjes mblidhen të dhënat mbi nxënësin dhe përcillen të gjitha udhëzimet e nevojshme për të lehtësuar futjen e nxënësit në shkollë dhe për të mbështetur familjen në këtë proces. Ndërsa gjatë vitit shkollor bashkëpunohet me mësuesit dhe familjet për të favorizuar integrimin.

Sporteli është hapur gjatë gjithë vitit shkollor një mëngjes në javë, zakonisht të premten, nga ora 8.00 deri në 12.00: gjithsesi mund të kërkontë takim edhe në një ditë tjetër.

Aktiviteti i këtij sporteli ndiqet nga një mësuese dhe nga dy ndërmjetësuese kulturore, një në gjuhën kineze dhe tjetra në gjuhën arabe e franceze. Ka raste ku mundet të ofrohet shërbimi, në bazë të kërkesave, edhe në gjuhë të tjera.



VINI RE

Nëse keni paqartësi apo vështirësi mund ti drejtoheni gjithmonë :

- mësuesit tuaj referues
- kujdestarit të klasës
- sportelit të ndërmjetsimit kulturor
- drejtorit të shkollës.

JU UROJMË SHKOLLË TË MBARË





“... Për të rritur një fëmijë nevojitet i gjithë fshati...”

(thënie e vjetër afrikane)



*Shkolla Spresiano-s
Via U. Foscolo, 4
31027 Spresiano (TV)*